

Mbi

Auditimin e Brendshëm

Ushtruar në Zyren me Një Ndalesë, Drejtoria e të Ardhurave, Drejtoria e Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve, Sektori Protokoll-Arkivit - Bashkia Shkodër

Njësia e Auditimit Brendshëm – Bashkia Shkodër bazuar në ligjin 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik”, VKM nr 212 date 30.03.2012 “Për miratimin e kriterëve për ngritjen e Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, zhvilloi një mision auditimi tematik në– Zyren me Një Ndalesë, Drejtorinë e të Ardhurave, Drejtorinë e Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve, Sektori Protokoll-Arkivit Bashkia Shkodër, për periudhën 01 korrik 2014 – 31 Maj 2018 nga auditimi rezultoi:

Permbledhje ekzekutive

Për qytetaret e Bashkisë Shkodër, ofrimi i shërbimeve administrative bëhet përmes Sistemit të Integruar së Zyrës me Një Ndalesë. Një ndër shërbimet administrative të ofruara është dhe pajisja e qytetareve të ineteresuara me “Vërtetim saktësim adrese”.

Për mënyrën e funksionimit të sistemit të integruar me një ndalese është miratuar rregullore “Shërbimet Administrative Bashkia Shkodër” ku përcaktohen hapat që ndiqen për kërkesat për shërbim sipas drejtorive. Për shërbimin e “Vërtetim Saktësim Adresave” nuk janë ndjekur hapat e përcaktuara në rregulloren për “Shërbimet Administrative Bashkia Shkodër”, qytetarët nuk paraqiten pranë sporteleve të zyrës me Një Ndalesë për të bërë aplikimin e kërkesës për aplikim por inspektorët e rajoneve sjellin një vërtetim të lëshuar nga rajoni, ku përmban informacionin për qytetarin dhe të gjitha kërkesat rregjistrohen në sistem nga specialisti i Z1N. Qytetari nuk pajiset me një kopje të formularit të kërkesës. Nuk janë krijuar dosje fizike për secilën kërkesë dhe nuk janë dorëzuar pranë protokollit, vërtetimet e paraqitura nga rajoni dërgohen direkt tek Specialisti pranë Drejtorisë së Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve. Vërtetimet për saktësimin e adresës nuk përmbajnë nr protokollit. Detyrimet vendore janë konfirmuar të shlyera edhe kur nuk ka qenë e mundur të sigurohet i plotë informacioni mbi historikun e shlyerjes së detyrimeve, nuk është bërë verifikimi që nga dita e rregjistrimit pranë Zyrës së Gjëndjes Civile. Konfirmimin detyrimeve vendore, në rastin kur qytetari është paraqitur me faturën për arkëtim, është bërë kur kanë shlyer 3 vitet e fundit, ndërsa për qytetarët që kanë kontrate të lidhur me Ujesjelles Kanalizime është bërë konfirmimi nëse kanë shlyer detyrimet që nga momenti që ka lidhur kontratën. Është bërë konfirmim për shlyerje detyrimesh për qytetaret të cilët kanë paraqitur akt-marreveshje me Ujesjellës-Kanalizime për shlyerje detyrimesh të prapambetura, ku përfshihet dhe detyrimet vendore, pa u përcaktuar nga Keshilli Bashkiak, pasi është keshilli bashkiak që vendos rregullat bazë kufizuese në raport me agjentin.

GJETJET DHE REKOMANDIMET

1.Gjetje Bazuar në Rregulloren "Shërbimeve Administrative ne Bashkinë Shkodër" qytetari që do të pajiset me vërtëtim "Saktësim Adrese" duhej të ishte paraqitet pranë ZIN për të regjistruar kërkesen dhe të dhenat sëbashku me Librezen e konsumit të ujit dhe kartën e identitetit, si dhe duhej të ishte pajisur me një kopje të formularit të kërkesës. Nga auditimi rezultoi se inspektorët e rajoneve sjellin një vërtëtim të lëshuar nga rajoni, ku përmban informacionin për qytetarin dhe të gjitha kërkesat regjistrohen në sistem nga specialisti i ZIN. Qytetari nuk pajiset me një kopje të formularit të kërkesës.

2.Gjetje Bazuar në Rregulloren "Shërbimet Administrative ne Bashkinë Shkodër" duhej të ishte bërë dorëzimi i të gjitha dosjeve fizike nga Specilaisti i ZIIN pranë Sektorit të Protokoll- Arkivit në fund të ditës, ku të firmosej për dorëzimin e tyre në librin e protokollit. Nga auditimi rezultoj se nuk janë krijuar dosje fizike për secilen kërkesë dhe nuk janë dorëzuar pranë protokollit. Vërtëtimet e paraqitura nga rajoni dërgohen direkt tek Specialisti pranë Drejtorisë së Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve.

3.Gjetje Bazuar në nenin 12 i Rregullores së Arkivit ne Republikën e Shqipërisë „për normat tekniko –profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, Dokumentet që dalin nga organi shtetëror një ndër elementet që duhet të kenë është Data dhe numri i protokollit. Nga auditimi rezultoj se vërtëtimet për saktësimin e adresës nuk përmbajnë nr protokollit.

Rekomandimi nr.1. Të ngrihet një grup pune me specialistat e drejtorive përkatëse ku të rishikohet rregullorja aktuale e ZIN, duke marrë në konsideratë nenet 74-76 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative ne Republikën e Shqipërisë, V.K.M nr. 625 date 26.10.2018 “Për miratimin e manualit të etikës në ofrimin e shërbimeve publike në sportel”, rishikimin e të drejtave dhe përgjegjësisve të punonjësve që përdorin sistemin dhe të përcaktohet qartë diagrama elektronike, rekomandojmë që ZIN-a të përmbyle procedurën dhe të dorëzojë përgjigjen me shkrim qytetarit.

Rekomandim nr.2. Në zbatim të rregullores çdo aplikim duhet të trajtohet me shkrim si në rastin kur miratohet kërkesa ashtu dhe në rastin kur refuzohet kërkesa.

Rekomandimi nr.3. Për çdo "Vërtëtim Saktësim Adrese" pasi të nënshkruhet dhe vulolet nga titullari, duhet të protokollohet. Gjithashtu duhet të krijohet regjistër i veçantë që të nënshkruajnë personat që i tërheqin vërtëtimet.

4.Gjetje Bazuar në rregulloren e “Për shërbimet administrative ne Bashkinë Shkodër” çdo qytetar që paraqitet në sportelet e Zyrave me Një Ndalesë, shqyrtimi i shërbimeve administrative duhet të kryhej vetëm pasi Drejtoria e të Ardhurave ka verifikuar nëse aplikanti ka shlyer

detyrimet vendore,ku sipas paketës fiskale afati i pagesës së detyrimeve vendore për çdo familje është 30 ditë nga dita e regjistrimit pranë Zyrën e Gjëndjes Civile .Nga auditimi rezultoi se për qytetaret që janë paraqitur për të marrë vërtetim “saktësi adrese” dhe që nuk ka qenë e mundur të sigurohet i plotë informacioni mbi historikun e shlyerjes së detyrimeve,nuk është bërë verifikimi që nga dita e regjistrimit pranë Zyrës se Gjëndjes Civile.

5.Gjetje Bazuar në nenin 35 pika 2 për ligjin nr.9632 DT. 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore “ rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e detyrimeve vendore duhej të ishin përcaktuar nga Këshilli Bashkiak. Nga auditimi rezultoi se gjatë verifikimit të shlyerjes së detyrimeve për qytetaret që kanë aplikuar për tu pajisur me vërtetime, nga Drejtoria e të Ardhurave është punuar me dy standarte.Për qytetarët që kanë tërhequr faturën për arketim pranë sporteleve është bërë konfirmimi për shlyerje detyrimesh nëse kanë shlyer 3 vitet e fundit,ndërsa për qytetarët që kanë kontrate të lidhur me Ujesjelles Kanalizime është bërë konfirmimi nëse kanë shlyer detyrimet që nga momenti që ka lidhur kontraten,duke vepruar në kundërshtim me pikën 2 të nenit 35 për ligjin nr.9632 DT. 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore “ .

6.Gjetje Bazuar në nenin 35 pika 2 për ligjin nr.9632 DT. 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore “ rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e detyrimeve vendore duhej të ishin përcaktuar nga Këshilli Bashkiak. Nga auditimi rezultoi se është bërë konfirmim për shlyerje detyrimesh për qytetaret të cilët kanë paraqitur akt-marreveshje me Ujesjellës-Kanalizime për shlyerje detyrimesh të prapambetura,ku përfshihet dhe detyrimet vendore.Bazuar në paketën fiskale detyrimet vendore paguhet me këste për çdo muaj për çdo familje.

7.Gjetje Bazuar në rregulloren e “Për shërbimet administrative në Bashkinë Shkodër” kur pranë ZIN paraqitet qytetari me mandat pagesë për shlyerjen e detyrimeve,qe janë konstatuar të papaguara dhe kanë kaluar në statusin “Për shlyerje detyrimesh”,specialisti i ZIN e skanon mandatin dhe e dërgon kërkesën për shqyrtim nëpërmjet sistemit pranë Drejtorisë së Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve.Nga auditimi rezultoi se specialisti i ZIN ,nuk ka kthyer për rishqyrtim rastet të cilat kanë rezultuar me parë të cilat nuk kanë shlyer detyrimet.

Rekomandimi nr.4.Bazuar në nenin 35 pika 2 për ligjin nr.9632 DT. 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore “ i ndryshuar,për praktikën e deritanishme të mbledhjes së tarifave vendore të bëhet propozim pranë Këshillit Bashkiak për miratimin e rregullave të mbledhjes së tarifave vendore, përcaktimit të periudhës të mbledhjes së tarifave dhe përcatimit të masave shtrënguese, dhe procedurave që ndiqen për mbledhjen e tarifave vendore.

Njësia Auditimit Brendshëm

Bashkia SHKODER

